



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



SISTEMI I PAGESAVE

Departamenti i Sistemeve të Pagesave





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Sistemi i Pagesave



BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: +383 38 222 055
Fax: +383 38 244 410

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org;

AUTORË Departamenti i Sistemit të Pagesave



PËRMBAJTJA

1. Çka është pagesa	7
2. Çka janë instrumentet e pagesave?	8
3. Si të zgjedhim një instrument pagese?	9
4. Çka janë Sistemet e Pagesave?	10
5. Pse janë të rëndësishme sistemet e pagesave?	12
6. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	13
7. Sistemi i Pagesave	14
7.1. Pagesat Normale	14
7.2. Pagesat Prioritare	14
7.3. Pagesat Masive	15
7.4. Pagesat Giro (Kos Giro)	16
7.5. Debitimi Direkt	17
8. Arkitektura e funksionimit të sistemit të pagesave	18
8.1. Sa kushtojnë transferet ndërbankare për bankat dhe klientët?	19
8.2. Mbikëqyrja e Sistemeve të Pagesave në Kosovë	20
8.3. Perspektivat e Sistemit të Pagesave	21

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Transferimi i fondeve nga llogaria e qiramarrësit te qiradhënësi -----	11
Figura 2. Skema e pagesave masive-----	17
Figura 3. Kliringu dhe shlyerja e fondeve -----	20

1. Çka është pagesa

Pagesë është një transferim i vlerave monetare nga njëra palë te tjetra, si nga blerësi te shitësi apo nga urdhëruesi te përfituesi (person fizik ose juridik). Pagesa zakonisht bëhet në këmbim për sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.

Forma më e thjeshtë dhe më e vjetër e pagesave është shkëmbim i drejtpërdrejtë i një malli apo shërbimi për një tjetër. Në botën moderne, pagesat nga një individ zakonisht bëhen duke përdorur para të gatshme, kartela ose transfere të tjera bankare.



Një qytetar i Kosovës sot përdor instrumente të ndryshme të pagesave për të dërguar dhe pranuar fonde. Ai ose ajo paguan në para të gatshme në dyqan, në çdo fillim muaji pranon në llogarinë bankare të tij pagën mujore nga punëdhënësi apo pensionin, paguan faturën për shpenzimet e shërbimeve publike përmes E - banking, etj.

2. Çka janë instrumentet e pagesave?

Instrument të pagesave janë çdo instrument që i mundëson mbajtësit apo përdoruesit transferimin e fondeve.

Termi “instrument pagese” aplikohet për numër të konsiderueshëm të formave të pagesave, siç janë kartelat për pagesa, urdhërpagesat, etj. Në kuptim të gjerë, instrumente të pagesës janë të gjitha mjetet që lejojnë bartësin të bëjë një transferim të fondeve apo të tërheqë fonde. Ekzistojnë dy lloje të instrumenteve: instrumentet në letër dhe instrumentet elektronike. Këto të fundit janë një fenomen modern dhe janë krijuar në bazë të zhvillimeve teknologjike dhe avancimeve në fushën e komunikimit. Instrumentet letër përfshijnë pagesat përmes letrës, transferimet e parave, etj. Ndërsa instrumentet elektronike përfshijnë kartelat për pagesa, pagesat përmes telefonit apo urdhërpagesave elektronike dhe paraja elektronike.

Instrumentet e pagesave jo në para të gatshme më të përdorurat në Kosovë janë: transferet e kreditit dhe kartelat. Transferet e kreditit janë udhëzime nga paguesi bankës së tij që të debitojë llogarinë bankare të tij dhe t’ia kreditojë llogarinë bankare përfituesit të fondeve. Ndërsa kartelat me funksion pagese (kartela debiti ose krediti) janë kartela që lëshohen nga bankat komerciale. Ato i japin mundësi mbajtësit të kartelës të paguajë me fondet në llogarinë bankare të tij (kartelë debiti) ose të tërheqë në një linjë krediti (kartelë krediti) deri në një limit të autorizuar. Pagesat me kartela kanë potencial që të rriten edhe më shumë në vitet në vijim.

... tërheqim para të gatshme përmes



Blejmë dhuratën e përkryer

Paguajmë në dyqan përmes POS-it...



... i befasojmë të afërmit për ditëlindje me 100 EUR kredit

... paguajmë faturën e rrymës



Rezervojmë hotelin për pushime

3. Si të zgjedhim një instrument pagese?

Faktorët përcaktues për zgjedhjen e një instrumenti janë:

- Vlera e transaksionit: A është për pagesa me vlera të mëdha apo për vlera të vogla?
- Lehtësia e dërgimit të pagesës: A mund lehtësisht të dërgojë dhe pranojë pagesa?
- Çmimi i instrumentit: Sa kushton përdorimi i këtij instrumenti?
- Rreziqet: Çfarë rreziqe ekzistojnë në përdorimin e instrumentit?
- Vendndodhja: A është për pagesa ballë për ballë kundrejt pagesave në distancë?
- Frekuenca: A është për pagesa për vetëm një herë kundrejt pagesave të përsëritshme?
- Përhapja e instrumentit dhe pranimi nga t regtarët: A mund ta përdori këtë instrument në shumë vende?



Përgjigjet në pyetjet e mësipërme na dërgojnë te zgjedhja e duhur e instrumentit. Për pagesa me vlera të vogla në dyqan, ku shitësi është përballë, atëherë më e përshtatshme është pagesa me anë të parave të gatshme. Por nëse duam të blejmë një shtëpi në para të gatshme, ajo nuk është fare praktike.

Pagesa në para të gatshme bartin në vete rreziqe të ndryshme, siç janë falsifikimi, vjedhja dhe kosto e mbajtjes dhe e transportit. Për këtë arsye përdoren instrumentet jo në para të gatshme, sepse në këtë mënyrë evitohen rreziqet e lartpërmendura.

4. Çka janë Sistemet e Pagesave?

Sistemet e pagesave si tërësi pasqyrojnë instrumentet, procedurat dhe gjithë infrastrukturën për transfer parash përmes llogarive bankare. Çdo instrument pagese përmban në vetvete një numër hapash dhe procedurash për transferimin e fondeve përmes llogarive bankare. Këta hapa sigurojnë se pagesat kryhen ashtu siç duhet, shpejt dhe sigurt.

Figura 1 . Transferimi i fondeve nga llogaria e qiramarrësit te qiradhënësi



Le të marrim si shembull një qytetar në Republikën e Kosovës, që kryen pagesën e qirasë përmes bankës së tij duke përdorur një urdhërpagesë. Kur qiradhënësi ka llogarinë në të njëjtën bankë, atëherë kjo pagesë njihet si pagesë brenda bankës apo intrabankare, ndërsa kur qiradhënësi ka llogarinë në një bankë tjetër prej qiramarrësit, atëherë kjo pagesë njihet si pagesë ndërbankare. Qytetari në bankën e tij pagesën e inicion përmes një urdhërpagese të cilën banka ia vë në dispozicion klientit. Në formular plotësohen të gjitha fushat standarde të obliguara, si: llogaritë e bankës/klientit urdhërues dhe pranues, shuma, data, numri referues, etj. Pas nënshkrimit të urdhërpagesës, ajo dorëzohet në sportelin e bankës dhe në vazhdim fillon procedimi i asaj pagese, përmes skemës/sistemit të pagesave.

5. Pse janë të rëndësishme sistemet e pagesave?

Sistemet e pagesave janë pjesë vitale e infrastrukturës ekonomike dhe financiare.

- Sistemet e pagesave ofrojnë kryerjen e sigurt dhe në kohë të transaksioneve. Kompanitë i përdorin kur blejnë apo shesin mallra dhe shërbime; individët kur i marrin pagat dhe kur blejnë me pakicë; dhe institucionet qeveritare kur i marrin taksat dhe pagesat e përfitimeve.
- Sistemet e pagesave lejojnë konsumatorët e një banke për të bërë pagesat për klientët e bankave të tjera. Këto ndërlidhje bankare bëjnë të mundur, që qytetarët në zgjedhjen e bankës ku t'i vendosin paratë e tyre të përqendrohen dhe të zgjedhin ato banka, që ofrojnë koston dhe cilësinë e shërbimeve më të mira. Ata nuk kanë nevojë të kenë parasysh nëse njerëzit dhe institucionet nga të cilët ata marrin ose kryejnë pagesa përdorin të njëjtën bankë.
- Sistemet e pagesave janë jetike për funksionimin e tregjeve financiare. Pjesëmarrësit e tregut financiar mbështeten në marrjen në kohë të fondeve nga ana e bankave të tyre në mënyrë, që të investojnë paratë e tyre me kohë.

Funksionimi i sistemeve të pagesave në mënyrë efikase, duke lejuar transaksionet që të kryhen në mënyrë të sigurt dhe në kohë, jep një kontribut kyç për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Çka ndodh nëse ato nuk funksionojnë: ju nuk mund ta përdorni kartelën tuaj, pagën nuk e merrni në kohë, etj. Sistemet e pagesave po ashtu mund të jenë një kanal për transmetimin e çrregullimeve nga një pjesë e ekonomisë ose sistemit financiar në një tjetër. Ky " rrezik sistemik" është një arsye e rëndësishme pse Banka Qendrore e Kosovës kujdeset për funksionimin e mirë të sistemeve të pagesave.

6. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Roli i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), është që të rregullojë, nxitë dhe mbështetë Sistemin e Pagesave. Më saktësisht, Ligji i Bankës Qendrore ndër të tjera i jep BQK- së këto kompetenca të veçanta vijuese:

- të ofrojë shërbime, duke përfshirë kredi brenda-ditore të kolateralizuara me letra me vlerë të negociueshme të qeverisë, për sisteme të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe për pjesëmarrësit në to, për të garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të tilla.
- të organizojë, të posedojë, të marrë pjesë dhe të operojë sistemet e referuara
- të bëjë rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë ashtu siç specifikohet më tej me ligjet përkatëse.

Pra, përveç rolit të saj si rregullues dhe reformator për zhvillimet e reja dhe ngritjet në teknologji dhe në standarde të pranuar ndërkombëtarisht, ajo po ashtu operon sistemin e vetëm për pagesa ndërbankare në vend.

7. Sistemi i Pagesave

Hapat e përfshirë në kryerjen e një pagese ndërbankare, ndahen në dy kategori:

1. Kliringu apo procesi i transmetimit, shkëmbimit të të dhënave dhe në disa raste të konfirmimit të kërkesave të pagesës, dhe
2. Shlyerja apo rregullimi final i fondeve, që është i pakthyesëm.

Hapi i parë është kur transferet e pagesave nisen-shkëmbehen në mënyrë elektronike në mes të pjesëmarrësve (kliringu) dhe pastaj ato pagesa rregullohen në llogari (sipas pozicioneve të tyre në debi apo kredi). Kështu që kliringu është një proces brenda të cilit urdhërpagesat e të gjithë anëtarëve (pjesëmarrës të SPN), shkëmbehen nga pala urdhëruese tek ajo pranuese dhe anasjelltas, njëkohësisht shumat neto përcaktohen për njërën dhe palën tjetër. Në Kosovë kliringu kryhet nëpërmjet Sistemit të Pagesave Ndërbankare (SPN).

Rregullimet dhe shlyerjet në llogari paraqesin hapin e dytë përmes të cilave veprime anëtarët e SPN-së, shfrytëzojnë fondet e tyre që të mbulojnë obligimet në bazë të kërkesave të anëtarëve të tjerë përmes regjistrimit dhe rregullimit për urdhërpagesa ndërmjet bankave dhe BQK-së, si agjent i organeve qeveritare në Kosovë. Ky shërbim ofron rregullimin tre herë në ditë të netos në llogaritë e BQK-së për urdhëresa të veçanta ose sasisë së letrave të urdhërpagesave të shumëfishta sikur që janë pagesat e pagave përmes llogarive bankare.

Në pajtim me të gjitha këto veprime funksionojnë procedura të qarta përmes të cilave janë të përshkruara veprimet mbi pesë mënyrat/modulet e pagesave në kuadër të Sistemit të Pagesave, si:

7.1. Pagesat Normale

Një transfer i kreditit i cili zakonisht inicohet në një degë të bankës komerciale nga paguesi i cili e plotëson një urdhërpagesë. Të dhënat e urdhërpagesës futen në sistemin e brendshëm të bankës komerciale dhe më pas përcillen te Sistemi i Pagesave Ndërbankare për kliring.


7.2. Pagesat Prioritare

Këto janë pagesa të cilat mund të dorëzohen në çdo kohë gjatë ditës së punës dhe të cilat të klirohen menjëherë nga SPN-ja individualisht në baza bruto në kohë reale pas dorëzimit, duke përfshirë edhe finalizimin e fondeve në llogari.

7.3. Pagesat Masive

Pagesat në grumbull/masive, janë pagesa nga një për shumë llogari ose nga shumë për një llogari. Ato paraqesin një transaksion kryesor debiti, të inicuar nga klienti përmes bankës së tij (banka A), me mundësi kreditimi për shumë llogari të përfituesve në banka të ndryshme (psh. banka B, C dhe D). Një transaksion kryesor me vlerë më të madhe i bashkëngjiten shumë pagesa me vlera të vogla, të inicuar nga e njëjta llogari për shumë llogari përfituese. Ky modul përdoret për pagesat e të hyrave të Qeverisë (Administrata Tatimore e Kosoves -ATK , Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës-FKPK,etj) dhe për pagesa të pagave dhe përfitime të tjera.

Figura 2. Skema e pagesave masive



7.4. Pagesat Giro (Kos Giro)

Kjo mënyrë e pagesës përdoret kryesisht për pagesat periodike të rregullta, taksat ose faturat të shërbimeve publike, etj. Ky model i zhvilluar në kuadër të Sistemit të Pagesave Ndërbankare fillimisht i është dedikuar pagesave të shërbimeve publike por pjesëmarrës mund të jenë edhe institucione e ndërmarrje tjera.

Pagesa e faturave përmes Kos Giros mund të bëhet në të gjitha bankat komerciale anëtare të

sistemit të kliringut, me një faturë standarde me mundësi leximi automatik përmes lexuesve të posaçëm të barkodeve. Kos Giro është duke u përdorur nga disa kompani publike dhe institucione qeveritare, e ndermarje.

7.5. Debitimi Direkt

Është instrument dhe skemë e pagesave e konsideruar ndër metodat më efikase të pagesave me vlera të vogla në shuma të ndryshme. Pra është metodë e sigurt dhe e përshtatshme për realizimin e pagesave të rregullta periodike, si për: fatura të ujit, rrymës, premi të sigurimeve, këste të kredive, etj. Mënyra që përdoret në këtë rast është autorizimi për Debitim Direkt, kur një autoritet apo klient, në bazë të marrëveshjes paraprake, autorizon bankën që të bëjë pagesa të rregullta nga llogaria e tij qarkulluese në llogarinë e biznesit përfitues.

8. Arkitektura e funksionimit të sistemit të pagesave

Procesi i kliringut dhe shlyerjeve në sistemin e pagesave është përfundimtar dhe i pakthyeshëm. Shkëmbimi i pagesave bëhet në baza individuale sipas krediteve të transferit (pagesë për pagesë) për pagesa prioritare, ndërsa i rregulluar në baza neto për pagesat e rregullta.

Sistemi i Ndërbankar i Pagesave, i quajtur, ATS (Automatic Transfer System/Sistemi i Transferit Automatik) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement/shlyerjet bruto ne kohe reale) i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House/sistem automatik i kliringut) që bën procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël, në tri sesione të kliringut ndërbankar në BQK.

Sistemi i Pagesave është i projektuar sipas standardeve më të reja ndërkombëtare për fushën e sistemeve të pagesave (ISO 20022), sipas teknologjisë më bashkëkohore, si dhe praktikave më të mira që e bën Kosovën njërin ndër vendet e para që implementon këtë standard.


Të dhënat e shkëmbyera brenda sistemit janë të bazuara në forma dhe numra të llogarive të përcaktuara sipas standardeve ndërkombëtare për numra të llogarive. Përmes sistemit, bëhet realizimi i pagesave brenda vendit, ku të gjitha debitimet dhe kreditimet e llogarive të bankave bëhen në sistemin e pagesave të BQK-së.

Secila pagesë ka numrin e identifikimit që t'ju shmangen gabimeve eventuale apo kreditimeve të dyfishta dhe të sigurohet, që janë në pajtim me rregullat dhe procedurat e kliringut dhe shlyerjes. Sistemi automatikisht kontrollon pajtueshmërinë e të dhënave dhe korrektësinë sipas kornizave të përcaktuara dhe standardeve.

Sistemi i kliringut plotëson kërkesat teknike të të gjitha procesimeve ditore të pjesëmarrësve për të cilët SPN në BQK është i hapur për operime që nga ora 8:00 në secilën ditë të punës.

Transferet e fondeve pranohen deri në ora 15:45 për pagesat prioritare dhe 15:15 për të gjitha pagesat e tjera.. Për mbylljen e ditës së operimeve vjen mesazhi me përgjigje mbi kryerjen e veprimeve, pozitive apo negative. Nëse mesazhi është negativ, SPN në BQK duhet të përgjigjet urgjentisht, të iniciojë dhe bënë të mundur procesin përfundimtar brenda një ore në të gjitha rrethanat e krijuara.

Figura 3. Kliringu dhe shlyerja e fondeve



8.1. Sa kushtojnë transferet ndërbankare për bankat dhe klientët?

Çmimi për klientët e bankave që kryejnë pagesa ndërbankare përmes këtij sistemi është i caktuar nga vetë bankat komerciale dhe sipas politikave të tyre të shërbimit për klient. Nga ana e Bankës Qendrore, tarifa për shërbime të sistemit të pagesave është caktuar vetëm sa të mbulojë kostot operative të mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemit dhe është plotësisht i krahasueshëm me praktikatat e vendeve në regjion dhe më gjerë.

8.2. Mbikëqyrja e Sistemeve të Pagesave në Kosovë

Banka Qendrore është mbikëqyrëse e sistemeve të pagesave. Ky është një funksion i rëndësishëm i saj, i cili është i lidhur direkt me funksionet e tij kryesore të mbajtjes së

stabilitetit ekonomik dhe të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit financiar. Përmes mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave objektivat e sigurisë dhe të efikasitetit promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt këtyre objektivave edhe aty ku është e nevojshme, duke stimuluar ndryshime.

BQK-ja mbikëqyr dhe monitoron sistemet e pagesave si tërësi, instrumentet dhe mënyrat e pagesave në vend në pajtim me rregullat, procedurat dhe vendimet përkatëse. Në BQK mirëmbahet baza e shënimeve statistikore dhe jostatistikore mbi sistemet e pagesave në vend. Informacionet e duhura statistikore rreth sistemeve të pagesave dhe shlyerjes së letrave me vlerë grumbullohen nga operatorët, pjesëmarrësit e sistemeve (bankat, institucionet, etj.) dhe burimet e tjera. E pajisur me këto informacione BQK-ja siguron që sistemet e pagesave respektojnë praktikatat, standardet dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht (BIS, ECB, CPSS, etj.). Me rëndësi të veçantë është analizimi i sistemeve të pagesave në vend kundrejt 24 parimeve bazë të komitetit mbi sistemet e pagesave dhe të shlyerjes (BIS - CPSS).

Lidhur me sigurinë e sistemeve të pagesave, mbikëqyrja duhet të identifikojë dhe të vlerësojë rreziqet e një sistemi të pagesave dhe të verifikojë, që ai sistem ka mekanizmat e duhur të kontrollit të rrezikut. Në këtë mënyrë mbikëqyrja e sistemeve të pagesave mbron integritetin e gjithë sistemit financiar, duke parandaluar trazirat e ardhshme nga të transmetuarit nga një institucion në tjetrin dhe nga një sistem apo treg në tjetrin.

Rreziqet e mundshme në të cilat një sistem i pagesave është i ekspozuar mund të jenë të një natyre financiare, operative dhe ligjore. Rrezik financiar mund të jetë rreziku i likuiditetit ose rreziku i kredisë. Rreziku i likuiditetit shkaktohet kur një apo disa pjesëmarrës nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre të pagesave në momentin e shlyerjes, vetëm më vonë. Rreziku i kredisë ndodh kur ky detyrim nuk mund të realizohet as në një datë në të ardhmen. Rreziku operativ ndodh kur ka dështime teknike, gabime njerëzore dhe shkakton mangësi në funksionimin e sistemit. Së fundi, rreziku ligjor përbëhet nga ekzistenca e boshllëqeve ligjore që mund të ndikojnë në sigurinë ligjore të transaksioneve. Në varësi të madhësisë së problemit të krijuar nga ndonjë prej rreziqeve dhe kapacitetit të tij për t'u përhapur, rreziku sistemik mund të materializohet.

Në praktikë, rreziqet e përmendura më sipër nuk mund të eliminohen plotësisht. Megjithatë, roli i mbikëqyrjes është për t'u siguruar që operatorët e sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësit e tyre janë të vetëdijshëm për rreziqet, janë në gjendje për të vlerësuar shkallën e tyre dhe kështu të pranojnë një shkallë të caktuar të pranueshme të rrezikut.

Përveç s'igurisë, efikasiteti është objektiv t'jetër që synojnë mbikëqyrësit. Krijimi i një sistemi plotësisht të sigurt do t'i ngarkonte pjesëmarrësit e sistemit me kosto tepër të larta, në krahasim me efektivitetin e sistemit. Prandaj qëllimi kryesor është që të arrihet një balancë mes sigurisë dhe efikasitetit. Në këtë pikë të ekuilibrit do të kemi sistemet e pagesave që kanë koston më të ulët të mundshme dhe përpunimin më të shpejtë të mundshëm të pagesave.

8.3. Perspektivat e Sistemit të Pagesave

Nga pikëpamja e perspektivës, parësore është që të sigurohet shkëmbim dhe shlyerje automatike e pagesave ndërbankare, përmes ndërlihdjeve të sofistikuar në pajtim me praktikat më të mira dhe parimet kryesore të përcaktuara nga BIS (qendra për standardet ndërkombëtare të bankave në Bazel). Në këtë konetekt tanimë janë përcaktuar strukturat standarde, është zhvilluar dhe implementuar sistemi i pagesave “shlyerje bruto në kohë reale- RTGS”, të bazuar në standarde të ISO 20022 dhe SWIFT (Shoqëria për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Botëror).

Përmes SPN-së është e mundur që të gjithë pjesëmarrësit të shkëmbejnë jo vetëm urdhërtransferet por të bëhen edhe shërbime të tjera si: kërkesa e balancave, mbitërheqjeve,

ndërrime të prioriteteve, shlyerje, gjendja e balancës minimale të lejuar dhe qasje në kohë reale për gjendje të llogarive për të gjithë pjesëmarrësit.

Në përputhje me këto objektiva, Departamenti i Sistemit të Pagesave i Bankës Qendrore synon një përmirësim dhe plotësim të vazhdueshëm të bazës rregullative, si për sistemin ashtu edhe për instrumentet e pagesave, me qëllim të përafrimit me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe forcimin e mëtejshëm të mbështetjeve ligjore të aktiviteteve për rritje të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org